



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 29.06.2018

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 27.06.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik **“INFINIT” SHPK** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizimi me laptop, projektor dhe aparate fotokopjuese për Institucionet Arsimore”**, me Nr. të Prok: **616-18-043-12** nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e grupit të Operatoreve Ekonomik: **“INFINIT” SHPK** të dt. 27.06.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Furnizimi me laptop, projektor dhe aparate fotokopjuese për Institucionet Arsimore”** me Nr. **616-18-043-1-2-1** kundër *Njoftimit për anulimin e aktivitetit të Prokurimit të AK*, të datës 26.06.2018.
2. **Vërtetohet** vendimi i AK për *anulimin e aktivitetit të Prokurimit* me datë: 26.06.2018;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të *anuloj aktivitetin e prokurimit për “Furnizimi me laptop, projektor dhe aparate fotokopjuese për Institucionet Arsimore”* me Nr. **616-18-043-1-2-1**.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Ne Dosjen e Tenderit të përshkrimi i çmimit në pozicionin 2 dhe 3 keni ofruar se: Projektori do të jete prodhim Bench – Kinë dhe Aparatet fotokopjuese prodhim Konica Minolta – Kinë. Në sqarimet e kerkuara nga Autoriteti kontraktues dhe deshmite që ju keni ofruar lidhur me keto dy pozicione keni vërtetuar se ju keni ofruar: për projektor – acer dhe aparate fotokopjuese Ricoh Aficio MP 301 SPE qka është në kundërshtim me ofertën tendë që keni ofruar dhe në kundërshtim me rregullat e LPP, andaj edhe Autoriteti Kontraktues ka bërë vlerësimin duke u mbështetur në kriteret e dhëna në Njoftimin për kontratë dhe në Dosjen e Tenderit gjithnjë duke u bazuar në LPP dhe në Udhëzuesin për Prokurim Publik.

Sipas nenin 59.2 të LPP, dhe sipas interpretimit të KRPP-se të datës 05.06.2018, **nuk lejohet** një ndryshim i tillë pasi që konsiderohet ndryshim substancial i ofertës.

Nenin 59.2 i LPP përcakton “*Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkojen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues.*

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

